



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 09. 02. 2015, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati - ZPRK, Sanije Berisha-OSBE, Gurjeta Zeka-VV, Argjend Zejnaj - GP/AAK, Plator Avdiu- QKJS, Bashmir Xhemaj dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Haki Demolli;
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21 janar 2015;
4. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit;
5. Formimi i grupeve të miqësisë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21 janar 2015;

Kryetari konstatoi se, Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21 janar 2015, me vërejtjen e deputetit Qerim Bajrami, që në diskutimin e tij pas fjalës “vendet e tjera”, të shtohen fjalët “të hapësirave turkfolëse”.

3. Raportimi i ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Haki Demolli;

Enver Hoxhaj falënderoi ministrin Haki Demolli dhe Gjenerallejtënant Kadri Kastratin, për pjesëmarrje në mbledhjen e Komisionit, duke shtuar se janë të ftuar meqë Komisioni e sheh FSK-në si instrument që i shërben politikës së jashtme.

Qëllimi i këtij takimi tha Hoxhaj është mbi të gjitha, të informohemi mbi prioritetet e MFSK-së gjatë vitit 2015, për shqetësimet e saj, për procesin e transformimit të FSK-së, procesin e anëtarësimit të Kosovës në Kartën e Adriatikut, Partneritetin për Paqe dhe se çka mund të bëjë Komisioni për Punë të Jashtme në këtë drejtim.

Haki Demolli lidhur me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Forca të Armatosura të Kosovës, tha se MFSK-ës ka qenë bartëse e procesit të rishikimit të strategjisë të sektorit të sigurisë, ku janë nxjerr edhe rekomandimet kryesore për vitin 2013-2014. Ai shtoi se procesi i transformimit është duke shkuar në bashkëpunim të thellë me DIRI-në, që është një ekip i specializuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me ekipet këshilluese të NAT-it dhe NLAT-it, që janë në kuadër të MFSK-së, e që janë ekipe këshilluese të NATO-së, Gardën Kombëtare të Ajrovë të SHBA-së si dhe me mekanizmat politiko-ushtarak pranë Ambasadës së SHBA-së. Si rezultat i këtij bashkëpunimi është hartimi draft ligjit për transformimin e FSK-së në FAK. MFSK-ja ka ngritur Komisionin për implementimin e rekomandimeve, që ka përgatit pakon e dokumenteve të planifikimit strategjik, në të cilën bëjnë pjesë: Plani i veprimit për implementim, Plani për strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, sipas misionit të ri dhe Plani afatgjatë i zhvillimit të FAK-ut.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe bilateral, ministri Demolli tha se MFSK-ja ka nënshkruar gjithsej 11 memorandume bashkëpunimi me 11 shtete, 9 prej të cilave janë anëtare të NATO-së, kurse 2 janë anëtare kandidate për pranim në NATO.

Ai shtoi se MFSK-ja është duke punuar edhe në nënshkrimin e disa memorandumeve gjatë vitit 2015 dhe shtoi se MFSK-ja ka nënshkruar programin e partneritetit shtetëror me Ajrovën, që është kontribuuesi kryesor i FSK-së në fushën e arsimimit, asistencës logjistike si dhe në përkrahjen financiare.

Demolli njoftoi se MFSK-ja ka nënshkruar marrëveshjen SOFA me Republikën e Shqipërisë dhe është në përgatitje të nënshkrimit të një marrëveshjeje të ngjashme me Republikën e Maqedonisë.

Si të rëndësishme për MFSK-në ai e vlerësoi përfaqësimin ushtarak të Kosovës jashtë vendit, duke shtuar se aktualisht janë 6 Atashe, në SHBA, Belgjikë, Gjermani, Turqi, Suedi dhe në Shqipëri dhe janë të interesuar që numri i atashëve ushtarakë të zgjerohet.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Demolli tha se MFSK-ja në bashkëpunim me MPJ-në ka identifikuar organizatat në të cilat synohet anëtarësimi, kështu MFSK-ja është anëtare në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal dhe në Qendrën Rajonale të Asistencës për Verifikimin dhe Implementimin e Kontrollit të Armëve. Në cilësinë e shtetit mysafir, tha se jemi në Kartën e Adriatikut dhe se synim për vitin 2015 është anëtarësimi si vëzhgues apo anëtar i plotë në Kartën e Adriatikut.

Lidhur me integrimet euroatlantike, ministri Demolli tha se Republika e Kosovës aspiron për tu anëtarësuar në NATO, duke shtuar se procesi i anëtarësimit në strukturat euroatlantike zhvillohet në emër të Qeverisë dhe negocimi me NATO-në për anëtarësim bëhet përmes MPJ-së.

Si sfidë për anëtarësim të Republikës së Kosovës në NATO, e sheh pozicionin e disfavorshëm në raport me vendet tjera të rajonit, për arsye se 4 shtete të NATO-së, ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës si Spanja, Greqia, Rumania dhe Sllovakia.

Më tej ai shtoi se disa zyrtarë të NATO-së mendojnë se një shtet për tu anëtarësuar në NATO duhet të jetë anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), por ka edhe zyrtarë të tjerë, që bazuar në traktatin e NATO-së të vitit 1949, nuk e shohin të domosdoshëm të qenit anëtar i OKB-së, për tu anëtarësuar në NATO.

Ministri vlerësoi se duhet të bëhet institucionalizimi i marrëdhënieve me NATO-në, sepse Kosova nuk ka marrëdhënie formale, prandaj në këtë drejtim duhet të hartohet Plani i Veprimit të Partneritetit Individual, ku duhet të theksohen kërkesat për rritjen e kapaciteteve ndërevepruese të FSK-së, për përmbushjen e misionit të ngarkuar. Pas aprovimit të këtij plani nga NATO-ja, hapet rruga që FSK-ja të anëtarësohet në Partneritetin për Paqe.

Më pas ministri shtjelloi trajnimet e stafit të FSK-së në shkollat e NATO-së dhe planet për trajnime gjatë vitit 2015. E konsideroi të rëndësishme tha ai, krijimin e një bërthame të përfaqësimit civilo-ushtarak në NATO, pranë Ambasadës së Kosovës në Bruksel, me qëllim të parapërgatitjes për përfaqësim në NATO, në kohën kur Kosova do të jetë pjesë e Partneritetit për Paqe, theksoi ministri Haki Demolli.

Ramush Haradinaj tha se pozicioni i Kosovës dhe i FSK-së në politikën e jashtme lidhet me besimin që e fiton FSK-ja nga qytetarët e vendit, përfshirë komunitetet etnike dhe veriun dhe se duhet të gjendet një mënyrë e kujdesshme që FSK-ja ta ketë të njëjtin status në gjithë territorin dhe besimin e të gjithëve. Haradinaj shtoi se si Komision janë të gatshëm të ndihmojnë aq sa mund të vlerësohet në etapa të caktuara.

Puhie Demaku kërkoi të informohet se përveç ligjit, sa është punuar në transformimin brenda FSK-së, për takimin e Kryeministrit Mustafa në NATO, se a është koordinuar me ministrinë dhe cilat kanë qenë temat e bisedimeve. Demaku pyeti në lidhje me atë se çka përbëjnë ndryshimet nga FSK-ja në FAK, buxhetin, votat e nevojshme për miratimin e ligjit dhe se a është e kushtëzuar Ushtria e Kosovës nga minoritetet dhe për çfarë kushtëzimesh bëhet fjalë.

Zafir Berisha tha se FSK-ja është storie e suksesit në Kosovë dhe se FSK-ja ka nevojë për mbështetje të institucioneve, veçanërisht të Kuvendit. Duke u ndërlidhur me raportimin e ministrit, lidhur me numrin e atasheve ushtarakë, Berisha pyeti se a ka mungesë të kuadrit profesional, pasi që është një numër i vogël i atasheve në krahasim me ambasadat që kemi.

Haki Demolli rreth pyetjeve të shtruar nga deputetja Demaku, tha se rreth transformimit të FSK-së në FAK, nuk është saktësuar se në cilën periudhë do të ndodhë, mirëpo, ky është një proces që merr kohë. Sa i përket pyetjes lidhur me koordinimin me Kryeministrin Mustafa, ai tha se janë koordinuar para se të ndodh takimi dhe se para dy javëve sekretari i NATO-së z. Stoltenberg ka qëndruar në Kosovë, me të cilin kanë mbajtur takime pune.

Për transformimin e FSK-së në FAK, Demolli tha se ndryshmi përcaktohet në misionin e FAK-ut, ku përveç tjerash do të ketë edhe misionin e mbrojtjes së integritetit dhe sovranitetit.

Lidhur me buxhetin tha se ministria tani ka buxhet rreth 45 milionë euro, për planin 10 vjeçar të procesit të transformimit, por për shkak të vonesave që do të ndodhin në aprovimin e ligjit dhe disa implikimeve financiare, viti 2015 është shpallur vit zero financiar. Për 2/3 e votave tha se janë të angazhuar maksimalisht, mirëpo, kjo varet nga deputetët si për ndryshimet kushtetuese ashtu edhe për ligjin.

Sa i përket pyetjes së deputetit Berisha, Demolli tha se kostoja financiare për mbajtjen e një Atasheu është mjaftë e lartë, por do të shikohet që në aspektin territorial të ketë një shtrirje në Evropë dhe disa vende të Kuintit, me mundësi që të ketë edhe Atashe jorezident.

Kadri Kastrati tha se është bërë përgatitja e atasheve, janë disa rezervë që kanë përfunduar Akademinë Diplomatike Ushtarake dhe bazuar në prioritetet e MPJ-së, janë të gatshëm të ofrojnë atashe të tjerë të shkolluar.

Teuta Rugova pyeti lidhur me efektet negative në vonesën e krijimit e FAK-ut dhe konkursin për kadetët që do të shkojnë në Akademinë Amerikane Ushtarake në West Point, si ka shkuar ky konkurs dhe sa ka qenë përzgjedhja e suksesshme.

Blerta Deliu-Kodra pyeti ministrin për gatishmërinë e pjesëtarëve të FSK-së, për t'ju dalë në ndihmë zonave të përmytura në Kavajë. Si ka shkuar misioni dhe cilat kanë qenë sfidat për t'ju dalë në ndihmë këtyre zonave.

Ramush Haradinaj pyeti ministrin se në rast të ndryshimit të gatishmërisë për dinamikë a mendon se është e mundur me ndryshimin e rrethanave të ndryshojë edhe dinamika e planifikuar 10 vjeçar.

Haki Demolli duke iu referuar pyetjeve të deputetes Rugova tha se çdo vonesë mund të ketë efekte të caktuara, mirëpo, ne jemi të interesuar që sa më parë të fillojë faza legjislative, në mënyrë që të fillohet me implementimin e tyre.

Sa i përket konkursit, Demolli tha se kanë qenë të gatshëm të dërgojnë kandidatët që janë më të mirë të përgatitur, kanë kërkuar brenda FSK-së persona që i plotësojnë kriteret e parashtruara, pastaj është zgjeruar konkursi, duke kërkuar edhe nga jashtë, mirëpo, nuk kanë gjetur të tillë.

Kadri Kastrati lidhur me pyetjen e deputetes Blerta Deliu-Kodra, tha se bazuar në kërkesën e Republikës së Shqipërisë dhe pas miratimit të Presidentes, Qeverisë, ministrit dhe pas urdhrat të dhënë, është dërguar një kontingjent prej 9 pjesëtarëve dhe pajisje speciale, që janë kërkuar nga Republika e Shqipërisë, të cilët e kanë kryer punën ashtu siç duhet dhe pas përfundimit të misionit është kërkuar të tërhiqet kontingjenti. Po ashtu, tha se brenda vendit FSK-ja është duke operuar në Komunën e Lipjanit, ku pjesëtarët e FSK-së janë duke e kërkuar një 12 vjeçar që ka humbur. Sa i përket ndryshimit të planit 10 vjeçar, Kastrati tha se me kërkesë të Qeverisë, FSK-ja ka kapacitete që të ndërhyjë në planin dinamik, mirëpo, kjo ka të bëjë edhe me ndryshimet në mbështetje financiare.

Ismet Beqiri tha se FSK-ja dhe MFSK-ja përbëjnë ndër segmentet më vitale të shtetit dhe ne si deputetë e kemi obligim që në çfarëdo rrethane, nevojat dhe kërkesat që vijnë nga MFSK-ja dhe nga FSK-ja t'i përkrahim sepse në situatat jo vetëm më të rënda, shihet se sa e rëndësishme është për vendin të kesh, një forcë të tillë të përgatitur profesionale.

Elmi Reçica theksoi se është Komisioni FunkSIONAL, i cili merret me çështje të sigurisë, por neve si Komision i Punëve të Jashtme na intereson të prezantoni realitetin në Kosovë dhe njëkohësisht të insistoni që përmes Brukselit dhe përmes atasheve ushtarakë, të keni ndikimin e fuqishëm tek të gjitha vendet e NATO-së.

Qerim Bajrami në mes tjerash theksoi se kur bëhet fjalë për komunitetet e tjera, duhet theksuar se për cilin komunitet bëhet fjalë. Komuniteti boshnjak, turk, rom, ashkali e egjiptian e konsiderojnë FSK-në e edhe FAK në të ardhmen, forcë të tyre, se do ta ndihmojnë nxjerrjen e ligjit dhe se do të jenë pjesë përbërëse e kësaj force në të gjitha nivelet.

Enver Hoxhaj tha se transformimi i FSK-së dhe formimi i FAK-ut është obligim ndërkombëtar që del nga pakoja e Ahtisarit. Po ashtu, ai tha se e kemi edhe një obligim tjetër ndërkombëtar që është

themelimi i gjykatës së posaçme dhe se duhet të amendamentohet Kushtetuta për këto çështje dhe pyeti se a duhet t'i votojmë këto të dyja në një pako amendamentuese kushtetuese.

Hoxhaj kërkoi të informohet për strategjinë e ministrisë lidhur me Partneritetin për Paqe, sa është punuar me OSBE-në, meqë në Partneritetin për Paqe, nuk mund të anëtarësohesh pa qenë anëtar i OSBE-së dhe më tej kërkoi mendimin e ministrit se a duhet Kosova ta ketë një strategji të sigurisë kombëtare.

Haki Demolli sa i përket amendamenteve kushtetuese që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së, tha se gjithsej janë 16 amendamente. Ato kanë kaluar në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka dhënë mendimin se mund të procedohen për Kuvend dhe shprehu mendimin se duhet të votohen si pako së bashku.

Kadri Kastrati në lidhje me bashkëpunimin me OSBE-në, tha se nuk kanë pasur ndonjë kontakt deri më tani. Strategjia kombëtare e sigurisë, tha Kastrati është një dokument i rëndësishëm për shtetin, i cili nuk është hartuar akoma, është një ndër dokumentet me prioritet që pritet të hartohet së shpejti.

4. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit;

Enver Hoxhaj rreth Planit dhe Programit të Punës së Komisionit, i njoftoi anëtarët e Komisionit se në draft të planit janë inkorporuar të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e Komisionit. Hoxhaj propozoi që në Planin e punës së Komisionit, në vazhdim të pikës së parë, të shtohen fjalët “dhe të ministrive të tjera si MFSK, MIE, MZHE, MD, MKRS”; në vazhdim të pikës së pestë të shtohen fjalët “dhe hartimi i Strategjisë për bashkëpunim ndërparlamentar” dhe në vazhdim të pikës së gjashtë, të shtohen fjalët “dhe hartimi i Strategjisë për integrim në strukturat parlamentare rajonale, evropiane e globale”.

Ai po ashtu theksoi se Komisionit i nevojitet Plani i Qeverisë, në mënyrë që të harmonizohet me Planin e Komisionit dhe propozoi që posa ta ketë atë Komisioni, do të mund të integrohen në Planin e Komisionit edhe çështje të tjera.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Plani dhe programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për vitin 2015, me propozimet e kryetarit të Komisionit.

5. Formimi i grupeve të miqësisë;

Enver Hoxhaj i njoftoi anëtarët e Komisionit se lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, ka paraqitur një propozim, ku parasheh formimin e grupeve të miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Francës, të Bundestagut Gjerman, të Italisë, të Austrisë, të vendeve të BE-së : Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Çekisë, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Hungarisë, Irlandës, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Holandës, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, të Kongresit të SHBA-së, të Kanadasë, të Australisë, të Japonisë, të Kuvendit të Madh Kombëtarë Turk, të vendeve të rajonit dhe parlamenteve të organizatave ndërkombëtare.

Puhie Demaku duke theksuar mosorganizimin e një punëtorie, lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, propozoi formimin e grupeve të miqësisë në mes të Kuvendit të Kosovës dhe secilit vend të BE-së veç e veç, ndërsa, për vendet e tjera, propozoi formimin e grupeve të miqësisë sipas ndarjeve kontinentale.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, **Qerim Bajrami, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Blerta Deliu- Kodra dhe Zafir Berisha**, lidhur me mënyrën e organizimit të grupeve të miqësisë dhe procedurat e formimit të tyre, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

I propozohet Kryesisë së Kuvendit që :

1. Të riformohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Francës, (i formuar me përfundimin e Kryesisë nr. 03-P-082/k , më 16 mars 2009);
2. Të riformohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Bundestagut Gjerman, (i formuar me përfundimin e Kryesisë nr. 03-P-097/k , më 21 prill 2009);
3. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Italisë;
4. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Austrisë;
5. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të parlamenteve të vendeve të BE-së: Belgjikës, Bullgarisë, Kroacisë, Qipros, Çekisë, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Hungarisë, Irlandës, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Holandës, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar;
6. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Kongresit të SHBA-së;
7. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Kanadasë,
8. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Australisë;
9. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Parlamentit të Japonisë;
10. Të riformohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Kuvendit të Madh Kombëtarë Turk, (i formuar me përfundimin e Kryesisë nr. 04-V-0134, më 30 janar 2012);

11. Të formohet Grupi i Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të parlamenteve të vendeve të rajonit dhe parlamenteve të organizatave ndërkombëtare.

Grupet parlamentare propozimet e tyre për grupe të miqësisë t'i propozojnë deri në fund të muajit shkurt.

6. Të ndryshme.

Enver Hoxhaj i njoftoi anëtarët se Komisionit se të gjithë ministrave, të cilët është vendosur që të raportojnë në Komision iu është bërë ftesa. Ftesës për raportim në Komision, tha se i është përgjigjur edhe Ministri Çollaku, i cili propozon datat e mundshme për raportim 2, 3, 16 dhe 17 mars.

Zafir Berisha duke u thirrur në kërkesën për raportim të ministrit të MPJ-së, theksoi se është e domosdoshme që Ministri Thaçi, të raportojë në Komision.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit: Zafir Berisha, Puhie Demaku dhe Ismet Beqiri, kryetari konstatoi se Komisionit nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të përsëriten ftesat për të raportuar në Komision, për ministrin e Punëve të Jashtme dhe për ministren për Dialog.

Data e raportimit të Ministrit për Integritet Evropian, të caktohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj